



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITETI PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

Shkronja e grupit	28.08.2024
Emri i grupit	03
Numri i grupit	2595
Grupi	3
Vitet	1

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti i Filologjisë

Lëndët/Pozitat: Pozita III/10

1. B296 Qytetërim islam I
2. B297 Gjuhë Osmane I
3. B298 Tekste shqipe me alfabet arab
4. B299 Qytetërim islam II
5. B300 Gjuhe osmane II
6. B301 Përkthim tekstesh arabe

Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtareve):

1. **Kryetar** prof.asoc.dr. Abdulla Rexhepi
2. **Anëtar** prof..ass.dr. Zeqije Xhafçe
3. **Anëtar** prof.ass.dr. Isa Sulçevisi

Kandidatët e paraqitur sipas pozitave/lëndëve të shpallura me thirrjen publike
(numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësisht nga numri i pozitave apo kandidatëve):

Pozita/lëndët: 1. Zymer Ramadani

Pozita: III/10

Lëndët:

1. B296 Qytetërim islam I
2. B297 Gjuhë Osmane I
3. B298 Tekste shqipe me alfabet arab
4. B299 Qytetërim islam II
5. B300 Gjuhe osmane II
6. B301 Përkthim tekstesh arabe



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyetimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).

Në "Thirrjen publike me nr. prot. 2/426, dt.25/7/2024, për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime" për ushtrime për lëndët si në pikën III.10 të së njëjtës është paraqitur një (1) kandidat.

Përzgjedhja e kandidatëve është bërë në bazë të kushteve të parapara me Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nr.2/254, dt.17.07.2024.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të parashtruara të kandidatit Zymer Ramadani kemi arritur në përfundimin se i njëjti i plotëson kushtet e mëposhtme:

1. Kandidati ka përfunduar studimet në fushën përkatëse: studimet universitare katër vjeçare në Programin e Shkencave Teologjike të Fakultetit të Shkencave teologjike të Universitetit Selçuk në Konja-Turqi (dëshmuar me diplomën e nostrifikuar nga MASHTI) si dhe studimet MA në programin *Studime Kulturore Orientale* të Departamentit të Orientalistikës së Fakultetit të Filologjisë – UP, dhe kështu ka arritur nivelin 7 të kualifikimit, sipas KKK-së.
2. Me Certifikatat e Notave të parashtruara vërtetohet se kandidati plotëson kushtin e notës mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit: Nota Mesatare e ponderuar (AGNO) 2.57, Totali i kredisë (GKT) 167 në studimet BA dhe Nota mesatare 9.40 në studimet MA.

Kandidati gjithashtu ka parashtruar edhe dëshmi për dy punime shkencore të botuara në revistat kombëtare siç është *Revista shkencore, kulturore, islame Edukata Islame - Kosovë*, dhe revista shkencore ndërkombëtare në *Revistën Dini Araştırmalar Dergisi Marife - Turqi*, përkthime artikujsh shkencore nga gjuhët orientale dhe redaktime librash në fushën përkatëse dhe autorësinë e librave për fëmijë.

Prandaj, meqenëse kandidati i plotëson kushtet e parapara me rregulloren dhe studimet e kryera e bëjnë atë kandidat të përshtatshëm për lëndët e kësaj fushe shkencore komisioni vendos që i njëjti të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrimet e lëndëve Qytetërim islam I, Gjuhë Osmane I, Tekste shqipe me alfabet arab, Qytetërim islam II, Gjuhë osmane II, Përkthim tekstesh arabe të përcaktuara për pozitën nr.III/10 të Thirrjes Publike të cekur më lartë.

Komisioni vlerësues

1. Kryetar prof. asoc. dr. Abdulla Rexhepi
2. Anëtar prof..ass.dr. Zeqije Xhaftçe
3. Anëtar prof.ass.dr. Isa Sulçevsi